

SGS

SGS Automotive Albania sh.p.k

**Pasqyrat financiare
dhe Shenimet Shpjeguese
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**





PËRMBAJTJA

	FAQJA
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR	5
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-22





SGS Automotive Albania Sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë shprehur në LEK)

Shënime	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Aktivet		
Aktivet afatgjata		
AA jomateriale ne proces	4,296,487	4,296,487
Aktivet afatgjata jomateriale	4 413,572,316	509,253,457
Totali i aktiveve afatgjata	417,868,802	513,549,943
Aktivet afatshkurtra		
Inventari	5 11,073,053	6,561,161
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	6 16,426,458	16,377,166
Parapagime tatim fitimi	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	7 186,631,443	374,788,695
Totali i aktiveve afatshkurtra	214,130,953	397,727,023
TOTALI I AKTIVEVE	631,999,756	911,276,966
KAPITALI		
Kapitali		
Kapitali aksionar	8 190,000,100	190,000,100
Humbja e akumuluar	0	0
Fitimi (Humbja e Periudhes)	147,993,401	132,577,595
Totali kapitalit	337,993,501	322,577,695
Detyrimet		
Detyrime afatgjata		
Dividend per tu paguar	0	89,099,299
Vlera e riinvestimit	11 163,020,516	171,604,400
Totali i detyrimeve afatgjata	163,020,516	260,703,699
Detyrime afatshkurtra		
Huatë afatshkurtra	9 0	227,834,964
Llogaritë afatshkurtra	10 122,383,803	91,026,915
Tatim fitimi i pagueshëm	8,601,937	9,133,692
Totali detyrimeve	130,985,739	327,995,572
Totali kapitalit dhe detyrimeve	631,999,756	911,276,966

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan nga Drejtimi i Shoqërisë më 29 Mars 2017:

Alexandros Michail

Administrator

Mirketa Purqi

Drejtor Finance

Shënimet shpjeguese në faqet 7-22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



SGS Automotive Albania Sh.p.k.**Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë shprehur në LEK)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
I. Të ardhura operative			
Të ardhura	12	864,406,889	804,927,643
Totali të ardhura operative		864,406,889	804,927,643
Shpenzimet			
Materiale dhe të përdorur për konsum	13	(20,486,464)	(14,638,887)
Shpenzime personeli	14	(226,748,288)	(201,833,917)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4	(117,964,231)	(105,786,398)
Shpenzime të tjera operative	15	(294,093,008)	(296,086,730)
Totali shpenzimeve		(659,291,991)	(618,345,932)
Fitim nga aktiviteti operacional		205,114,898	186,581,710
Shpenzime dhe të ardhura financiare			
E ardhura financiare		1,374,899	3,875,268
Shpenzime financiare		(8,632,832)	(12,653,519)
Shpenzimeve financiare, neto	16	(7,257,933)	(8,778,251)
Fitimi para tatimit		197,856,965	177,803,459
Tatimi mbi fitimin	17	(49,863,564)	(45,225,864)
Fitimi neto i vitit		147,993,401	132,577,595

Shënimet shpjeguese në faqet 7-22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



SGS Automotive Albania Sh.p.k.**Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit aksionar për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë shprehur në LEK)*

	Kapital i nënshkruar	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Më 31 dhjetor 2014	190,000,100	93,788,736	283,788,836
Fitimi i vitit	-	132,577,595	132,577,595
Dividend i pagueshëm	-	(93,788,736)	(93,788,736)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	190,000,100	132,577,595	322,577,695
Fitimi i vitit	-	147,993,401	147,993,401
Dividend i paguar	-	(132,577,595)	(132,577,595)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
Më 31 dhjetor 2016	190,000,100	147,993,401	337,993,501

Shënimet shpjeguese në faqet 7-22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



SGS Automotive Albania Sh.p.k.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:		
Fitimi pas tatimit	147,993,401	132,577,595
Rregullime për:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	117,785,683	103,073,742
Shpenzime borxh i keq	178,548	-
(Fitim) / humbje nga kursi i këmbimit	(141,488)	79,363
Të ardhura nga interesat	(61,418)	(214,111)
Shpenzime per interesa	8,281,958	12,602,095
Shpenzime tatim fitimi	49,863,564	45,225,864
Provizgjone për çështje gjyqësore	7,145,407	-
Humbje nga shitja e aktiveve fikse	-	1,031,494
Efekti i rivlerësimit tek paraja dhe ekuivalentet e saj	(28,409)	(54,598)
Fitimi nga aktiviteti operativ para ndryshimeve në kapitalin punues	331,017,246	294,321,444
(Rritje) / rënie në inventar	(4,511,891)	917,200
Rënie / (rritje) në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	275,637	(353,235)
Rritje në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	5,987,447	33,608,127
Interesi i paguar	(9,668,921)	(17,350,400)
Tatimi fitimi i paguar	(41,261,627)	(47,210,061)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative	282,019,418	263,933,075
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale	(22,104,542)	(48,418,856)
Interesa të arkëtua	24,356	605,102
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese	(22,080,186)	(47,813,754)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet e financimit		
Shlyerje e huasë	(226,448,000)	(200,000,000)
Dividenti i paguar	(221,676,893)	-
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese	(448,124,893)	(200,000,000)
(Rënia) / rritja neto e parasë dhe ekuivalenteve të saj	(88,185,661)	16,119,321
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	374,788,695	358,614,776
Efektet e ndryshimeve në kursin e këmbimit tek paraja dhe ekuivalentet e saj	28,409	54,598
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	186,631,443	374,788,695

Shënimet shpjeguese në faqet 7-22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

SGS Automotive Albania sh.p.k (Shoqëria) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe e rregjistruar më 10 shtator 2009 në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit. Adresa e zyrave qendrore është në Tiranë, Rr. Irfan Tomini, Ndërtesa G & P, Kati i parë, Tiranë.

Shoqëria mëmë është SGS Societe General De Surveillance s.a., Gjenevë, Zvicër, e cila më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 zotëron 100% të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.

Aktivitet kryesorë të Shoqërisë lidhen me inspektimin teknik të mjeteve automobilistike, për një periudhë 10 vjeçare siç është rënë dakord në kontratën e konçesionit ndërmjet SGS Societe General De Surveillance s.a. dhe Ministrisë së Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë, e cila ka rolin e autoritetit kontraktues. Shoqëria operon në tregun vendas dhe ka hapur 15 pika në të gjithë vëndin.

Më 31 dhjetor 2016 punonjësit e Shoqërisë janë 165 (31 dhjetor 2015: 151).

1.1 Marrëveshja e Konçesionit

Përshkrimi i marrëveshjes

Sipas Nenit 100 të Kushtetutës dhe Nenit 21 të Ligjit Shqipëtar nr. 9663 “ Ligji i Konçesionit” (i ndryshuar) të datës 18 dhjetor 2006, vendimit të këshillit të ministrave nr. 27, i titulluar “ Mbi aprovimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së konçesionit”, i datës 19 janar 2007, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 643, të titulluar “ Mbi zgjedhjen e Autoritetit Kontraktual për dhënien e konçesionit të kontrollit të kërkuar teknik për mjetet dhe kamionët e tyre në Republikën e Shqipërisë, për (i)projektimin, financimin, rehabilitimin, testimin, përdorimin dhe mbajtjen qendarve të kontrollit teknik ekzistuese dhe makineritë dhe mjetet ekzistuese përgjatë periudhës së konçesionit; (ii) projektimin, financimin, ndërtimin, testimin, pronësinë, përdorimin dhe transferimin e projektit Qeverisë së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë dhe SGS General De Surveillance s.a që ka hyrë në marrëveshjen e konçesionit më datë 3 shtator 2009 (“Marrëveshja e Konçesionit”)

Periudha e konçesionit

Konçisioni është dhënë për një periudhë prej 10 vitesh që fillon nga data efektive (3 shtator 2009).

Objekti i konçesionit:

Autoriteti Kontraktues i jep Operatorit të drejtën të:

1. Të projektojë, financojë, rehabilitojë, testojë, të kete në përdorim, të shfrytëzojë dhe mirëmbajë QKT Ekzistuese dhe Pajisjet Ekzistuese për aq kohë sa do t'i kete në përdorim;
2. Të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të ketë në pronësi dhe në fund të periudhës së konçesionit të transferojë, të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë QKT e Re dhe Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike (qoftë ato të instaluar në QKT Ekzistuese dhe që do të zëvendësojnë Pajisjet Ekzistuese ashtu edhe ato në QKT e Re);
3. Të financojë, testojë, të ketë në pronësi dhe në fund të periudhës së konçesionit të transferojë, të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë QKTL dhe pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike të saj;
4. T'iu ofrojë Klientëve Shërbimin e Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në mënyrën e duhur dhe me profesionalizëm, në përputhje me këtë Kontratë, Manualin e Kontrollit të Mjeteve dhe Ligjin në tërësi.

Dorezimi i Mjedisëve të Konçesionit dhe Infrastrukturas

5. Në përfundim të Periudhës Konçesionare, Konçisionari do t'i kthejë Autoritetit Kontraktues përdorimin e QKT Ekzistuese;



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

6. Në përfundim të Periudhes Koncesionare, Konçesionari do t'i transferojë pa pagesë Autoritetit Kontraktues pronësinë mbi QKT e Re, QKTL si dhe mbi të gjitha Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike (si ato të QKT Eksistuese ashtu dhe ato të QKT të Re si dhe QKTL) si dhe, në çdo rast, do të kryejë të gjitha ato veprime të cilat janë pazgjydhshëmrisht të lidhura me veprimet e transferimit/kalimit të pronësisë dhe të nënshkruajë të gjitha aktet që do të bëjnë të mundur këtë kalim pronësie.
7. Procesi i Dorezimit do të fillohet të pakten 6 (gjashtë) muaj përpara mbarimit të Periudhes Koncesionare pas një inspektimi të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit.

Te drejtat e Konçesionarit

- Të ushtrojë të gjitha te drejtat në lidhje me përdorimin ekskluziv të Sheshit dhe të Paisjeve Ekzistuese, dhe të Paisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike (nga data e instalimit)
- Të punësojë apo angazhojë punonjës me qëllim zbatimin e Konçesionit si dhe të hartojë politikën e vet të punësimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe këtë Kontratë.
- Të kryejë veprime të tjera që i konsideron të nevojshme për të përmbushur detyrimet dhe të ushtrojë të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate.
- Të kërkojë zgjatjen e Periudhës së konçesionit në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.

Detyrime të Përgjithshme të Konçesionarit

- të zbatojë projektin e konçesionit në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate dhe anekset e saj.
- brenda 5 muajve, konçesionari duhet të ketë përfunduar rehabilitimin e QKT-ve ekzistuese si dhe në përputhje me ligjin.
- brenda 6 (gjashtë) muajve nga paisja me leje ndërtimi, konçesionari duhet të ketë përfunduar së ndërtuari QKT-në e Re.
- të ofrojë dhe kryej shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në përputhje me ligjet, manualin e kontrollit të mjeteve, praktikën e industrisë së mirë dhe ofertën e konçesionarit dhe të mbajë të pacënuar ofrimin e këtij shërbimi.
- nga data efektive të zbatojë si orar minimal pune në QKT ekzistuese, QKT e Re (pas ndërtimit në përputhje me këtë kontratë) dhe QKTL, orarin e hënë – e premtë 09:00-17:00 dhe e shtunë 08:00-13:00. Konçesionari gjatë këtij orari detyrohet të mbajë funksionale QKT Ekzistuese, QKT e Re (pas ndërtimit në përputhje me këtë kontratë) dhe QKTL. Ky orar mund të jetë objekt rishikimi me marrveshje me shkrim mes palëve mbi kërkesën e paraqitur nga pala e interesuar.
- të lejojë autoritetin kontraktues të inspektojë secilën nga QKT ekzistuese, QKT e Re dhe QKTL në çdo kohë të arsyeshme me ose pa njoftim paraprak.
- të kryejë kontrole teknike të gjitha mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre të paraqitura në testim në përputhje me Manualin e Kontrollit të Mjeteve.
- të mirmbajë QKT ekzistuese, QKT të Re dhe QKTL, paisjet ekzistuese dhe paisjet elektromekanike dhe kompjuterike deri në momentin e kthimit mbrapsht tek autoriteti kontraktues sipas kushteve të kësaj Kontrate në përputhje me praktikën e industrisë së mirë.
- të përballojë vetë të gjitha kostot dhe shpenzimet e çdo natyre lidhur me largimin dhe transportimin nga sheshi të paisjeve ekzistuese në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktues në përfundim të fazës së ndërtimit.
- të ruajë të gjitha vërtetimet e papërdoruara apo të palëshuara për rezultatet e kontroleve të kryera në QKT Ekzistuese, QKT e Re dhe QKTL në një vend të sigurt nën kontrollin e konçesionarit dhe në kushte të përshtatshme për t'i ruajtur ato nga dëmtimet e çdo lloji si psh mekanike, atmosferike, etj.



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

- t'i paraqesë autoritetit kontraktues në kohë të përshtatshme sapo t'i kërkohet prej tij informacione apo çdo dokument të kërkuar që ka të bëjë me funksionimin e QKT Ekzistuese, QKT e Re dhe QKTLsi dhe të shërbimit.
- të shoqërojë çdo pagesë të tarifës konçesionare me një raport dhe dokumenta të nevojshëm plotësues mbi xhiron e realizuar nga tarifat e kontrollit dhe tarifat e rikontrollit për periudhën për të cilën pagesa e tarifës konçesionare kryhet.
- të krijojë një bazë të dhënash elektronike të re dhe bashkëkohore dh eta përditësojë atë periodikisht. specifikimet teknike për realizimin e këtij procesi do të përcaktohen nga ana e stafeve teknike përkatëse të të dy palëve.
- në fund të periudhës konçesionare të transferojë (pa shpërblim apo pretendim tjetër monetary apo të çdo lloji) tek autoriteti kontraktues pronësinë mbi QKT e Re, QKTL, linjat e kontrollit dhe paisjet elektromekanike dhe kompjuterike në gjendje funksionale, përjashtuar amortizimin normal, ashtu siç do të jenë pas kryerjes së riinvestimit.
- të mos kryejë shërbimin ndaj mjeteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet fiskale që lidhen me përdorimin e mjeteve të tilla si; Taksa vjetore e qarkullimit rrugor, Taksa vjetore e rregjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe gjobat për mosparaqitjen brenda afateve për kryerjen e shërbimit në qendrat e kontrollit teknik.
- brenda muajit të parë të vitit kalendarik 7 të periudhës konçesionare, konçesionari duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor, kalendarin e punimeve të riinvestimit, ku të jenë përcaktuar afatet e riinvestimit dhe vlerat përkatëse sipas zërave.

Tarifat e konçesionit

1. Konçesionari detyrohet t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një Tarifë Konçesionit të barabartë më 5 % (pesë përqind) të Xhiros Vjetore (para tatim fitimit) që Konçesionari do të grumbullojë nga Tarifat e Kontrollit dhe të Rikontrollit (duke përjashtuar TVSH-ne), bazuar ne deklaratimet financiare te kontrolluara te Shoqerise Koncesionare per cdo Vit Financiar.
2. Detyrimi i Koncesionarit per pagesen e Tarifes se Koncesionit, fillon nga Data Efektive dhe paguhet me keste mujore brenda dates 15 (pesembedhjete) te muajit pasardhes

Investimet e Koncesionarit

Vlera që Konçesionari do të investojë për të bërë të mundur ofrimin e Shërbimit të Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove te tyre sipas kësaj Kontrate do të jetë 561.003.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e një milion e tre mijë) Lekë, nga të cilat 267.402.000 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion, e katërqind e dy mijë) Lekë do të destinohen për Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike.

Riinvestimet e Koncesionarit

Vlera e Riinvestimit që Konçesionari do të investojë me qëllim mirëmbajtjen dhe kthimin tek Autoriteti Kontraktues të makinerive, pajisjeve dhe sistemit kompjuterik të QKT në gjendje të përshtatshme për funksionim do të jetë 172.000.000 (njëqind e shtatëdhjetë e dy milion) Lekë që përfaqëson 30,7 % (tridhjetë pikë shtatë përqind) të Vlerës së Investimit dhe do të riinvestohet brenda 3 (tre) viteve të fundit të Periudhës së Konçesionit.

Ne rast se 4 (kater) muaj para perfundimit te Periudhes Koncesionare Koncesionari nuk ka kryer plotesisht apo pjeserisht riinvestimin detyrohet:

a) t'i paguajë menjehere Autoritetit Kontraktues diferencen e Vleres se Riinvestimit te pakryer mbi 56 100 300 leke kur Vlera e Riinvestimit te pakryer eshte me e madhe se kjo shume, ndersa pjesa e mbetur paguhet ditën e fundit të Periudhës Konçesionare;

b) t'i paguajë Autoritetit Kontraktues Vlerën e Riinvestimit te mbetur, nese ka te tille, ne ditën e fundit të Periudhës Konçesionare, kur Vlera e Riinvestimit te pakryer eshte me e vogel se 56 100 300 leke.



2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmerisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar nga SNRF për secilin prej aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar më poshtë në politikat kontabël.

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në Lek Shqiptar “Lek”.

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjyqimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultate aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjyqimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare kontabël duke marrë parasysh natyrën e operacioneve që Shoqëria ka.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara në fuqi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Standardet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht ndryshime të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale:

- **Ndryshimet e SNK 19 “Përfitimet e punonjësve”** – Përcaktimi i planeve të përfitimit: Kontributet e Punonjësve (efektive për periudhat që fillojnë nga 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standardet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2010-2012)”** – Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që i është bërë SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standardet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2011-2013)”** – Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 13 dhe SNK 40), kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014).



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Zbatimi i këtyre ndryshimeve tek standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime materiale në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje.

Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të Banka e Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
LEK / USD	128.17	125.79
LEK / EUR	135.23	137.28

3.3 Aktivet afatgjata jomateriale

Marrëveshje për shërbime konçesionare

Shoqëria njeh aktiv jomaterial afatgjatë nga një marrëveshje shërbimi konçesionare në momentin kur i lind e drejta për përdorimin e infrastrukturës së konçesionit. Aktivet jomateriale afatgjata janë matur fillimisht me kosto e cila është vlera e drejtë e paguar për të marrë shërbimet konçesionare të marrëveshjes konçesionare. Pas njohjes fillestare aktivet jomateriale afatgjata maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga dëmtimet.

Shoqëria ka aplikuar KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Konçesionare* të efektshme për periudhën vjetore më apo pas dates 1 janar 2008. Interpretimi është aplikuar për herë të parë në përgatitjen e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 në përputhje me IAS 8 Politikat Kontabël, ndryshimet në vlerësimet dhe gabimet kontabël të përshkruara në shënimin 22 të pasqyrave financiare. Sipas KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Konçesionare* aktivet afatgjata jomateriale përfaqësojnë të drejtën e Shoqërisë për të përfituar shërbimet konçesionare në këmbim të shpërblimeve jo monetare të kaluara Autoritetit Kontraktues.

Sipas marrëveshjes ndërmjet Shoqërisë dhe Autoritetit Kontraktues aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë elementët që përfshijnë shpërblime jomonetare në këmbim të shërbimeve konçesionare të marra:

- *Shpërblime jo-monetare (Qendra e Kontrollit Teknik dhe pajisje të lidhura me të)*

E drejta për të ofruar shërbime konçesionare në këmbim të përdorimit të Qendrave të Kontrollit Teknik ("QKT"), njihet në koston e investimit për projektim, financim, rehabilitim, testim, mirëmbajtje dhe përdorim të QKT-ve ekzistuese dhe pajisjeve të lidhura me të për të cilat konsiderohet si vlera e drejtë e tij.

Vlera e riinvestimit në 3 vjet aktivitet, paraqet një përmirësim të detyrueshëm të infrastrukturës së shërbimit të konçesionit zëvendësim në infrastrukturën origjinale të programeve dhe pajisjeve kompjuterike) i cili rrit jetën e aktivitet. Shpenzimet e përmirësimit (të skontuara me vlerën aktuale me një normë para takes që paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet për detyrimin specifik) matet si një aktiv afatgjatë jomaterial dhe njihet në fillim të periudhës së konçesionit dhe amortizohet gjatë të gjithë periudhës së konçesionit.



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

- Shpenzimet vijuese

Shpenzimet vijuese kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të përfshirë specifikisht në aktivin të cilit i përkasin. Shpenzimi tjetër është i njohur në pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse (në fitim ose humbje) kur ka ndodhur.

- Amortizimi

Jeta e dobishme e vlerës së mbetur të aktivit afatgjatë jomaterial që i përket marrëveshjes së shërbimit konçesonar është periudha që kur vendoset në dispozicion deri në fund të periudhës së konçesionit, 3 shtator 2019.

3.4 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivit e kalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë së tij, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm aktivësh që gjeneron rrjedhje parash që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura dhe shpenzime. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese të parasë, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar në vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit para taksës që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivit.

Përsa i përket aktiveve të tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që humbja nga rivlerësimi nuk ekziston më dhe që ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi, rimerret vetëm nëse vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën që do të ishte përcaktuar, neto me zhvlerësimin ose amortizimin, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

3.5 Instrumentat financiarë

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivativ që përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, huatë dhe detyrime tregatë dhe të tjera. Instrumentat financiarë jo-derivativ njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat jo në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke i shtuar çdo kosto që lidhet drejtpërdrejtë me transaksionin. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativ maten si më poshtë.

Në aktiv financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë në kushtet kontraktuale të aktivit. Shoqëria regjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivet financiare skadojnë ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset e parasë kontraktuale të aktivit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivit financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare regjistrohen në datën e tregtimit, data në të cilën Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë skadojnë, janë hequr ose anuluar.

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë të cilat kanë maturitet tre muaj ose më pak, të cilat nuk janë subjekt i rreziqeve të rëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrat e pozicionit financiar.



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka tregues objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të ndodhë një riorganizim financiar dhe mospagesa konsiderohen indikatorë që llogaritë e arkëtueshme janë zhvlerësuar.

Provizioni është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, të skontuara me normën e interesit efektiv. Aktivitetet me maturitet afatshkurtër nuk diskontohen. Vlera kontabël e aktivitetit zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie provigjoni dhe shumata e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, vlera në bilanc mbyllet kundrejt provigjoni për këtë llogari. Nëse shumata rikuperohen më vonë, ato regjistrohen në fitim ose humbje.

Huatë

Pas njohjes fillestare, huatë që mbartin interes regjistrohen me kosto të amortizuar me cdo diferencë midis kostos dhe vlerës së rimarrjes dhe njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes mbi bazën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar.

Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues objektiv që tregon se një ose disa dhe kanë pasur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivitetit financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivitetit. Aktivitetet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim bazë individuale. Aktivitetet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kreditit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në fitim dhe humbje.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga kryerja e shërbimeve. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë nga Shoqëria për shërbimet e kryera, duke përjashtuar taksat e shitjes dhe zbritjet.

Shoqëria zbaton kriteret e njohjes së të ardhurave të paraqitura si më poshtë për secilën pjesë të identifikueshme të transaksionit të shitjes, në mënyrë që reflektojë përmbajtjen e transaksionit. Shpërblimi i marrë nga këto transaksione, është shpërndarë veçmas për secilin komponent duke marrë parasysh vlerën relative të drejtë për secilin komponent.

Kryerja e shërbimeve

E ardhura nga kryerja e shërbimeve njihet kur shumata e të ardhurave mund të maten me besueshmëri, mbledhja është e mundshme. Kostot që kanë ndodhur ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme dhe kur kriteret për secilën nga aktivitetet e Shoqërisë janë plotësuar.

Këto kritere specifike të njohjes së të ardhurave nga aktiviteti janë bazuar në shërbimin e ofruar konsumatorit dhe kushteve të kontratës në secilin rast. Bazuar në Kontaktën e konçesionit midis SGS



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Societe General De Surveillance s.a. dhe Ministrinë e Transportit dhe Punëve Publike, Shoqëria është e autorizuar të ofrojë shërbime inspektimi të mjeteve të transportit siç është përcaktuar në kontratën e konçesionit.

Të ardhura nga interesat

Të ardhurat nga interesat përlllogariten në bazë kohore, duke iu referuar principalit të papaguar dhe normës së interesit efektiv.

3.7 Kapital i nënshkruar

Kapitali i nënshkruar përbëhet nga kontributet në para të themeluesve të Shoqërisë. Kapitali i nënshkruar mbahet në monedhën vendase LEK, i konvertuar nga monedha e huaj, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale

3.8 Përfitimet e detyrueshme të punonjësve

Kontributet e sigurimeve shoqërore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet e detyrueshme të pensioneve sipas legjislacionit vendor. Këto kosto të kryera në emër të Shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

3.9 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% e të ardhurës së tatueshme (2015; 15%).

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të. Në bazë të pasigurive të lidhura me realizimin e aktivitetit tatimor të shtyrë (të cilat vijnë nga diferencat e përkohshme të aktiveve për të cilat baza tatimore është më e madhe se vlera kontabël) të lidhura edhe me kohëzgjatjen e kontratës së konçesionit, Shoqëria nuk ka njohur një aktiv tatimor të shtyrë në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2016.

3.10 Provigjonet

Provigjonet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Nëse efekti është material, provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka mundësi për nevojën e një rrjedhë burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provigjonet rimerren.



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Provigionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigion për humbjet e ardhshme operative. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen.

3.11 Angazhime dhe detyrime të ardhshme

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Për një pasiv të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigion nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme do ta konfirmojnë atë, një detyrim lind në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

3.12 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtorët e Shoqërisë, së bashku me entitet që kontrollojnë, që kanë një ndikim të rëndësishëm mbi veprimet dhe drejtimin e Shoqërisë. Në marrjen në konsideratë të cdo marëdhënie të mundshme me palët e lidhura, vëmëndja i drejtohet thelbit të marëdhënies, jo vetem formës ligjore.

3.13 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin financiar të Shoqërisë në datën e raportimit (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së raportimit që nuk janë ngjarje rregulluese janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare nëse janë materiale.

3.14 Krahasues

Për qëllimin e krahasueshmërisë, interesi i përlogaritur I huave me vlerë (2015: 1,386,964 LEK) është riklasifikuar nga "Të pagueshme dhe të tjera" në "Hua". Ne vitin 2016 huate jane shlyer.



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

4. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivitet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë të përbëra si më poshtë:

	Pajisje IT	Të tjera	Riinvestimi	Totali
Kosto				
Gjendja më 31 dhjetor 2015	354,771,236	483,363,338	171,604,400	1,009,738,973
Shtesa	21,079,029	629,914	395,600	22,104,543
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	375,850,265	483,993,252	172,000,000	1,031,843,516
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2015	196,980,461	280,941,743	22,563,315	500,485,519
Shpenzimi për vitin	45,335,308	55,203,176	17,247,199	117,785,683
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	242,315,769	336,144,919	39,810,514	618,271,202
Vlera kontabël neto				
31 dhjetor 2015	157,790,775	202,421,595	149,041,085	509,253,456
31 dhjetor 2016	133,534,496	147,848,333	132,189,486	413,572,314



SGS Automotive Albania sh.p.k**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***5. INVENTARI**

Inventari më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 mund të përmblihet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2016	Më 31 Dhjetor 2015
Materiale ndihmëse dhe të konsumueshme	4,300,830	3,001,818
Çertifikatë inspektimi dhe të tjera	6,772,223	3,559,344
	11,073,053	6,561,161

6. LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE TË TJERA

Llogari të arkëtueshme nga shitjet dhe të tjera më 31 Dhjetor 2016 and 31 Dhjetor 2015 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2016	Më 31 Dhjetor 2015
Llogaritë e arkëtueshme		
Kliente	955,777	1,111,203
Premtim pagese të arkëtueshme	1,238,144	947,979
Totali i llogarive të arkëtueshme	2,193,920	2,059,182
Të tjera llogari të arkëtueshme		
TVSH e arkëtueshme	45,822	45,822
Garanci të dhena	72,800	223,784
Parapagimet	0	401,569
Shpenzime të periudhave të ardhshme	13,884,260	13,377,803
Të arkëtueshme nga personeli	229,656	269,006
Totali i llogarive të arkëtueshme të tjera	14,232,538	14,317,984
Llogaritë e arkëtueshme	16,426,458	16,377,166

Llogaritë e arkëtueshme nga shitjet dhe të tjera përbëhen nga debitorët vëndas, parapagimet e bëra për ndërtimet në vëndet e inspektimit dhe garanci të dhena për qera makinash në vitin 2013.

Shpenzimet e periudhave të ardhshme përbëhen kryesisht nga shpenzimet e shtyra të sigurimeve nga kontrata e nënshkruar me Sigal në dhjetor të vitit 2016 për shërbimet e sigurimit për vitin 2017 dhe shpenzimet e kalibrimit të Maha.

7. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor 2016 and 2015 janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2016	Më 31 Dhjetor 2015
Llogaritë në banka në Lek	174,987,870	297,437,690
Deposite Bankare	0	71,589,456
Llogaritë në banka në monedhë të huaj	1,857,471	2,607,732
Llogaritë në arka në Lek	9,769,554	3,140,862
Llogaritë në arka në monedhë të huaj	16,548	12,955
Totali	186,631,443	374,788,695



SGS Automotive Albania sh.p.k**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***8. KAPITALI AKSIONAR**

Më 31 dhjetor 2016 kapitali aksionar ka qënë LEK 190,000,100 (2015: LEK 190,000,100) dhe përfshin 1,900,001 aksione (2013: 1,900,001 aksione) me vlerë nominale Lek 100 për aksion, të zotëruara tërësisht nga SGS SOCIÉTÉ GÉNÉRALE DE SURVEILLANCE S.A.

9. HUATË AFATSHURTRA

Huatë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 mund të përmbliidhen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2016	Më 31 Dhjetor 2015
SGS SA, Geneva	0	226,448,000
Interes i përllogaritur	0	1,386,964
	0	227,834,964

Të gjitha huatë janë të marra nga Shoqëria mëmë dhe janë të pasiguruara. Huatë janë në LEK dhe mbartin interes. Interesi i huave për vitin 2016 është 4.22%. Huatë maturohen më 7 Nëntor 2016. Në këtë date, është shlyer huaja në vleren nominale prej 226,448,000 LEK sëbashku me interes e gjeneruara deri në këtë datë.

10. LLOGARITË E PAGUESHME DHE TË TJERA

Llogaritë e pagueshme më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2016	Më 31 Dhjetor 2015
Llogaritë e pagueshme		
- Furitorë të huaj	878,180	7,107,123
- Furnitorë vendas	46,642,701	33,443,714
Totali i llogarive të pagueshme	47,520,881	40,550,837
Të tjera të pagueshme		
Të tjera të pagueshme	20,029,049	18,283,150
TVSH të pagueshme	20,549,705	18,863,881
Te pagueshme ndaj Punonjesve	25,945,949	9,898,305
Shpenzime të përllogaritura	8,338,219	3,430,743
Totali i të tjera të pagueshme	74,862,922	50,476,078
Totali	122,383,803	91,026,915

Të tjera të pagueshme janë të përbëra nga të pagueshme per fatura te pamberritura, të pagueshme ndaj shtetit për sigurime shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat personale, tarifa koncensionare per tu paguar dhe të pagueshme të tjera.



SGS Automotive Albania sh.p.k**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***11. VLERA E RIINVESTIMIT**

Detyrimi aktual për të riinvestuar 30.7% të investimit total është njohur si një detyrim afatgjatë, meqenëse daljet e burimeve që përfaqësojnë përfitime ekonomike, do të nevojiten për të mbyllur detyrimin në tre vitet e fundit të periudhës së marrëveshjes.

Në shtator të vitit 2016, Shoqëria arriti vlerën e riinvestimit 172,000,000 LEK (që përfaqëson vlerën 30.7% të vlerës së investimit) dhe duke filluar nga ky muaj, të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe blerjes së aseteve do të shkojnë në uljen e vlerës së detyrimit të riinvestimit.

Më 31 dhjetor 2016, vlera aktuale e detyrimit të riinvestimit është 163,020,516 LEK (31 dhjetor 2015: 171,604,400 LEK).

12. TË ARDHURA

Të ardhurat më 31 Dhjetor 2016 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Tarifa për inspektimin e automjeteve	864,406,889	804,927,643
TOTALI	864,406,889	804,927,643

Shuma e deklaruar ne FDP per Qarkullimin Total eshte **944,146,585 Lek** sipas zerave te meposhtem:

Shitje e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve	865,163,870
Autongarkesa	78,982,715

Nga shitja e shërbimit, shoqëria ka njohur si të ardhura të shtyra vlerën **1,192,825 lek** e cila është vlerë e lidhur me shërbimet e faturuara dhe të likuiduara por që nuk u janë ofruar klienteve brenda vitit ushtrimor. Nderkohe nga të ardhurat e shtyra 2015, kanë kaluar në të ardhura të periudhës **330,080 Lek** si testim të kryera në 2015. Dhe 118,130 leke janë mbyllur si borxhe të keqija. Nga rrumbullakimet e librave në sistem është krijuar dhe diferenca prej 12,366 lek. Kete vlerë e gjeni të kalsifikuar në zerin **“Parapagime të marra”** në pasivët e shoqërisë për vitin ushtrimor 2016.

13. MATERIALE TË PËRDORURA

Materialet e përdorura më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Elektriciteti, uji dhe karburanti	8,813,840	7,702,799
Materiale ndihmëse dhe të konsumueshme nga shërbimet	9,732,999	6,023,727
Të tjera	1,939,624	912,361
TOTALI	20,486,464	14,638,887



SGS Automotive Albania sh.p.k**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***14. SHPENZIME PERSONELI**

Kostot e personelit më 31 Dhjetor 2016 dhe 2014 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Pagat bruto	186,028,882	171,323,537
Sigurimet shoqërore	25,764,224	23,168,835
Përlllogaritje për bonuset	5,176,013	1,494,514
Përlllogaritje për pushimet	0	177,355
Të tjera	9,779,108	5,669,676
TOTALI	226,748,228	201,833,917

15. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzimet e tjera operative janë te detajuara si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime logjistike dhe të ngjashme	51,470,240	49,125,876
Mirëmbajtja	29,156,931	30,447,178
Tarifa e konçesionit	43,257,290	40,309,078
Licensa dhe te drejta te tjera	72,638,206	73,718,482
Qira	12,898,488	11,515,512
Taksa dhe tarifa	5,764,989	4,637,654
Shpenzime transporti	5,735,028	7,074,250
Pajisje për zyra	3,843,292	2,751,258
Sigurime	4,877,530	4,406,410
Shpenzime të tjera	1,654,997	1,300,842
Shpenzime telekomunikacioni	3,684,764	2,152,817
Penalitete	6,433	21,904
Shpenzime pritje percjellje, Dhurata	406,487	537,961
Shpenzime dietash dhe udhëtime	1,312,870	2,079,165
Komisione bankare	677,914	687,601
Shpenzime marketingu dhe promovimi	56,707,549	67,001,902
Shitje aset	0	-1,681,162
TOTALI	294,093,008	296,086,730



SGS Automotive Albania sh.p.k
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

16. TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Kostot dhe të ardhurat financiare detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura financiare		
Të ardhura nga interesi	61,418	-
Të ardhura të tjera financiare	1,313,481	3,875,268
Totali i të ardhurave financiare	1,374,899	3,875,268
Shpenzime financiare		
Shpenzime interesi	(8,281,958)	(12,602,095)
Humbje nga kursi i këmbimit	(593,819)	(188,581)
Të ardhura nga kursi i këmbimit	242,945	137,157
Totali i shpenzimeve financiare	(8,632,832)	(12,653,519)
Humbje financiare neto	(7,257,933)	(8,778,251)

17. TATIMI MBI FITIMIN

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	%	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	%
Fitimi para tatimit	197,856,965	100%	177,803,459	100%
Norma e tatim fitimit	29,678,545	15%	26,670,519	15%
Shpenzimet e pazbritshme	20,185,019	10%	18,555,345	10%
Shpenzime tatim fitimi (15%)	49,863,564	26%	45,225,864	25%

Lista e detajuar e shpenzimeve te pazbritshme fiskalisht:

Shpenzimet e pazbritshme per efekt fiskal 2016

a- Gjoha	6,433
b-shpenzime per personelin	13,633,596
c- shpenzime te tjera	54,232,677
d-Amortizime	66,241,441
e -borxh i keq	178,548
f -dhurata	274,097

Totali i shpenzimeve te pazbritshme

134,566,792

Kompania është subjekt i taksës mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e tatimit është 15% për 2016. Formularët e deklarimit të taksave dorëzohen çdo vit. Ligjet shqiptare dhe rregullat e taksimit janë subjekt i interpretimit nga autoritetet e taksave.



SGS Automotive Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

18. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Angazhimet

Nuk ka zotime të rëndësishme kapitale të kontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, që nuk janë njohur tashmë në pasqyrat financiare.

Detyrimet e taksave

Për vitet 2009 - 2012, regjistrimet dhe librat tatimor të Shoqërisë janë inspektuar nga autoritetet tatimore vendase. Shoqëria ka ndjekur të gjitha rregullat dhe rregulloret tatimore në llogaritjen e detyrimeve tatimore, gjithsesi interpretimet e taksave sipas autoriteteve tatimore mund të ndryshojnë nga ato të përdorura nga Shoqëria.

19. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat mund të kërkojnë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.

